



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:135863

Datë: 12.07.2022

Numri i dokumentit: 03218871

P.nr. 414/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse-praktikante Dinore Xhemajli, në lëndën penale ndaj të pandehurit: V.P. për shkak të veprës penale: Dhunë në familje nga neni 248 par.1 të Kodit nr.06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.1388/2022 (2022:0047822), të datës 03.07.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 12.07.2022, në prezencën e Prokurorës së Shtetit Natasa Tamic dhe të pandehurit, të njëjtën ditë e shpalli publikisht dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

V.P., nga i ati B., e ëma S., e vajzërisë U., “data e lindjes”..., në Mitrovicë, ku edhe tani jeton, punon si konsulent ndaj klientit në kompaninë “S...”, me nr. personal:..., i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse,

Më datën 02.07.2022, rreth orës 18:30, në Mitrovicë, në banesën e cila është pronë e të dëmtuarës, në të cilën jeton me bashkëshortin dhe me dy fëmijët e mitur, në gjendje të alkoolizuar prej 0,72% alkool në frymë, ka ushtruar dhunë psikologjike ndaj bashkëshortes së tij - të dëmtuarës, H.LL., e tërë kjo me qëllim të cenimit të dinjitetit personal, rehatisë dhe integritetit shpirtëror të së njëjtës, në atë mënyrë që pasi që është kthyer e dëmtuara nga qyteti me fëmijët e saj të mitur e ka goditur me grusht murin e banesës duke i thënë të dëmtuarës fjalë kanosëse me përmbajtje si në vijim: “nuk mund të dalësh kur të duash ti, ke me më pa sherrin edhe ti edhe te zja jote, ti e di mirë se çka kam me të bë”, e pas kësaj ka filluar që të gjuaj jastëk në drejtim të së dëmtuarës, gjë e cila tek e dëmtuara ka shkaktuar frikë dhe shqetësim për jetën e saj, pasi që nuk është hera e parë që i pandehuri po ushtron dhunë psikologjike ndaj bashkëshortes së tij.

Me këtë ka kryer veprën penale: Dhunë në familje nga neni 248 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69 e 248 të KPRK-së, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri gjatë periudhës verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen vepër tjetër penale.
2. Dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 të KPRK-së, ashtu që dënimin me gjobë mund t'ia zëvendësoj me dënim me burg, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 (njëzet) euro gjobë.
3. Të akuzuarit, koha e kaluar në masën e arrestit shtëpiak nga data 03.07.2022 deri më datën 12.07.2022 i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë.
4. Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 30€, ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
5. Pala e dëmtuar, H.Ll., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.
6. Të akuzuarit i ndërpritet masa e arrestit shtëpiak, menjëherë, sot, datë 12.07.2022.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1388 /2022 (2022:0047822), të datës 03.07.2022, kundër të pandehurit V.P., për shkak te veprës penale: Dhunë në familje nga neni 248 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 12.07.2022, ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke shtuar se më vjen keq për rastin që ka ndodhur, nuk kam pasur qëllim që ta lëndoj të dëmtuarin pasi që me të njëjtën i kemi dy fëmijë dhe kemi jetuar së bashku deri në momentin kritik dhe në të ardhmen mendojmë ti rregullojmë raportet nëse ajo pranon.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se konsideroj se janë kushtet për pranimin e fajësisë, pranimi është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion, pranimi mbështetet në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, pranimi është bërë pas sqarimeve të mjaftuara nga ana e gjykatës për pasojat dhe benifitet e pranimit të fajësisë, andaj i propozoj Gjykatës që ta pranoj pranimin e fajësisë, të akuzuari ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë te cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-së, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: deklarata e të dëmtuarës H.Ll. e dhënë në polici me datë 03.07.2022; deklarata e të pandehurit V.P. e dhënë në polici me datë 03.07.2022; raporti i policit i datës 02.07.2022. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën

dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë së të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Dhunë në familje nga neni 248 par. 1 të KPRK-së, e për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së. Si rrethanë rënduese gjykata ka marr faktin se kjo veprë penale ka ndodhur brenda familjes, respektivisht e dëmtuar është bashkëshortja e tij, e që kjo është rrethanë rënduese sipas par. 2 të nenit 248 të KPRK-së, rrethanë tjetër rënduese është marr edhe fakti se vepra është kryer në praninë e fëmijëve të tyre të mitur, çka kjo ka ndikuar në gjendjen psikike të tyre e ku pasojat mund të jenë shumë më të mëdha. Ndërsa si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, shprehjen e keqardhjes të bërë në seancë, faktin se ka premtuar se nuk e përsërit këtë veprë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore gjykata të pandehurit i shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i këtij dënimi, i paraparë sipas nenit 38 të KPRK-ës, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit dhe nga të gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është në përputhshmëri me shkallën e përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë shoqërore për veprën penale për të pandehurin.

Vendimi për llogaritjen e kohës së kaluar në masën e arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar gjykata e ka bazuar në nenin 79 të KPRK-së, ku përcaktohet se në dënimin e shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në masën e paraburgimit apo arrestit shtëpiak.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2, pika 2.6 dhe nenit 453 par.1 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensimn viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Gjykata ndaj të akuzuarit ka ndërprerë masën e arrestit shtëpiak, në kuptim të nenit 367 par. 4 të KPP-së, duke qenë se është shpallur aktgjykimi dhe ndaj të akzuarit është shqiptuar dënim me gjobë dhe dënim alterbnativ, kështu që nuk ka asnjë kusht ligjor për qëndrimin e mëtejshëm të tij në masën e arrestit shtëpiak.

Për realizimin e kërkesës pasurore juridike, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil, në kuptim të nenit 463 të KPP-së.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 të KPPK-ës nga arsyeje të lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr. 414/2022, datë 12.07.2022
2022:135863, 12.07.2022

Procesmbajtësja:
Dinore Xhemajli

Gjyqtari
Rrahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.